

KËRKESË
Nr. 606/5, datë 21.12.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 528, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën 1/1 të re për zhvillim, në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë”.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak, të llogaritur si:

1. Për pasuritë e llojit “arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelat e publikuara dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 528, datë 24.6.2020, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, ka sjellë zbritje të vlerës së përgjithshme të shpronësimit të pronarëve, nga 20,932,039 (njëzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e nëntë) lekë në 20,611,147 (njëzet milionë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lekë, me efekt zbritës në shumën 320,892 (treqind e njëzet mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, vlerën e ndryshuar, sipas rastit, pas veprimeve për lidhjen e marrëveshjeve/kontratave të shkëmbimit, mes pronarëve të shpronësuar dhe njësisë zbatuese.

DREJTOR I PËGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMIT
DHE/OSE SHKËMBIMIT
Erlis Hereni

